



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 592/prot.,
4

Tiranë, më 26.02.2019

VENDIM
Nr. 19, datë 26.02.2019

PËR
MIRATIMIN E KANDIDATIT FITUES NË POZICIONIN E PUNËS “SPECIALIST”
PRANË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të pikës 17 të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 27, datë 29.12.2017 “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 51, datë 26.12.2018 “Për caktimin e kriterëve dhe procedurës së punësimit....”, pasi shqyrtoi materialet për procedurën e ndjekur nga Komisioni ad-hoc, pas diskutimit në mbledhje, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë si kandidat fitues nga procedura e punësimit për pozicionin e punës “specialist” pranë Njesisë së Auditimit të Brendshëm, z. Majlind Shkira.
2. Bordi i Administrimit do të shpallë procedurën e konkurimit për këtë pozicion pune brenda 3 (tre) muajve.
3. Në bazë të pikës 7 të kriterëve dhe procedurës së punësimit të miratuar me vendimin nr. 51, datë 26.12.2018, ky vendim i dërgohet Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë për ndjekjen e procedurave të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Adriana BERBERI

Adriana Berberi

